



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORES,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 16862 Prot.

Lezhë, më 22 / 11 /2022

V E N D I M

Nr. 547, Datë 22 / 11 /2022

“PËR NDARJEN E QENDRËS SË VOTIMIT 0717/0 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE, DATË 14.05.2023”

Në zbatim të neneve 62, Pika 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 10019., datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të Dekretit Nr. 13864., datë 24.10.2022 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, si dhe në Udhëzimin Nr. 207., datë 28.10.2022 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”;

V E N D O S I:

1. Qendra e Votimit: **0717/0** në Njësine Administrative Shëngjin me adresë shkolla e Mesme, Ishull -Lezhë, me më shumë së 1000 (një mijë) zgjedhës të ndahen dhe të krijohet qendra e **QV 0717/03** me adresë shkolla e Mesme, Ishull -Lezhë.
2. Ky vendim i komunikohet Zyrës së Gjendjes Civile Shëngjin.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

